

Operacionet më themelore të njësive sintaksore

Mr. Agim Spahiu

16 shtator 2000

Përmbledhje

Në këtë shkrim autori është marrë me operacionet më themelore të fushës së sintaksës, një çështje kjo e patrajtuar në gramatikat e gjuhës shqipe, madje as në atë të ASHSH-së, siç është GRAMATIKA E GJUHËS SHQIPE, vëllimi II, Sintaksa.

Derisa në gjuhët e tjera kjo çështje është shpjeguar dhe tejkaluar, në gramatikat e gjuhës shqipe çështjes së operacioneve themelore sintaksore nuk i është kushtuar ndonjë trajtim i veçantë. Përveç zbërthimit të konstituentëve të njësive sintaksore që bëhet gati në çdo tekst të sintaksës së shqipes kur bëhet fjalë për gjymtyrët e fjalive veç e veç, çështja e operacioneve, në përgjithësi, asnjëherë në tekstet tona gramatikore, por edhe në literaturën tjetër gjuhësore, nuk është bërë ndonjëherë objekt i ndonjë trajtimi të veçantë. Kjo mund ta ketë, mendoj, vetëm këtë shpjegim: në gramatikat e gjuhës shqipe nuk është elaboruar fare pak trajtimi strukturalist i njësive sintaksore.

Në këtë artikull do të ndalemi vetëm në disa operacione gjuhësore sintaksore dhe së bashku me shembuj do të përpiqemi të sqarojmë esencën e tyre, por pa ndonjë pretendim të zbërthimit shterrues. Këtu do të ndalemi te: *segmentimi*, *substituimi*, *permutacioni*, *eliminimi*, *adicioni*, *transformacioni* etj.

Të gjitha këto operacione gjuhësore-sintaksore mund të realizohen në njësi të ndryshme kumtuese-komunikative që kanë formë dhe përmbajtje, që kanë një gramatikalitet të sajuar drejt dhe që kanë një kuptim dhe kumtim të caktuar komunikues. Pra duhet të vështrohen nga prizmi i gramatikalitetit dhe akceptabilitetit¹. Këtu shpeshherë kemi një mospërputhje në mes këtyre dy komponenteve, ngase në disa raste njësitë kumtuese gramatikisht mund të jenë në rregull, por semantikisht jo dhe anasjelltas.

1 Segmentimi

Është një prej operacioneve më themelore të fushës së sintaksës. Meqë kjo e fundit merret kryesisht me njësi sintaksore, duke filluar nga togfjalëshat e deri te fjalitë, periudhat e njësitë e tjera mbifjalioare, siç është teksti, çdo hartues i teksteve sintaksore, do të merret

¹Shih Heidrun Pelz, *Linguistik, Eine Einführung*, Hamburg, 1999, f. 149.

edhe me segmentimin e gjymtyrëve të ndryshme të fjalive: të gjymtyrëve kryesore, të dyta etj. Sa për sqarim po e marrim ndonjë shembull të thjeshtë: Për shembull, fjalia: *Postieri i fshatit shpërndan letrat në orën tetë*, segmentohet në tri sintagma: **sintagma nominale (SN)** *Postieri i fshatit*; **sintagma verbale (SV)**-*shpërndan letrat* dhe **sintagma prepozicionale (SP)**- *në ora tetë*.

2 Substituimi

Është një operacion që ka të bëjë me zëvendësimin, po e zëmë, të një njësie sintaksore me një njësi tjetër, duke e zbatuar segmentimin e secilës gjymtyrë veç e veç. Kështu, fjalia e lartshënuar ka mundësi të zëvendësohet, gjymtyrë për gjymtyrë nga një ose disa njësi të tjera. P.sh: Kryefjala (SN) *Postieri i fshatit* mund të zëvendësohet me *Ai/ Agroni/ Njeriu me kapele* ; (SV) me *na vështroi të gjithëve* dhe (SP) me *me radhë/ me kujdes* dhe të jenë korresponduese të saj, qoftë nga aspekti kuptimor, po ashtu edhe nga ai gramatikor. Pra, krahas: *Postieri i fshatit/ shpërndan letrat /në orën tetë/*, mund të kemi: *Njeriu me kapele/ na vështroi të gjithëve/ me radhë/*. **Permutacioni** ka të bëjë me ndërrim vendesh të gjymtyrëve të caktuara në ndonjë fjali.

Gjuha shqipe, sikundër dihet, nuk mund të radhitet në grupin e gjuhëve me renditje të ngulitur të gjymtyrëve në fjali. Me ndonjë përjashtim, ajo ka një rend përgjithësisht të lirë të gjymtyrëve në fjali, varësisht nga çështja e aktualizimit. Kështu p.sh. në gjuhën tonë mund të thuhet: *Studentët nga Kina vijnë në ora 10*. Por, mund të thuhet edhe: *Në ora 10 studentët nga Kina vijnë* ose: *Vijnë në ora 10 studentët nga Kina?* etj. Por nuk ka kuptim po të thuhet: *Nga Kina vijnë studentët në ora 10*, ose: *Studentët në ora 10 nga Kina vijnë*, ngase kanë kuptime të tjera nga njësia bazë. Në gjuhën gjermane mund të thuhet: *Die Studenten aus China kommen um 10 Uhr an*, ose: *Um 10 Uhr kommen die Studenten aus China an*, mirëpo nuk mund të thuhet: *Um 10 Uhr die Studenten aus China kommen an*; ose: *Die Studenten aus China um 10 Uhr kommen an*². Po kështu, edhe në gjuhën frënge mund të thuhet: *En toutes saisons je vais en vacances*, por nuk mund të thuhet: *En vacances je vais en toute saisons*³.

Gjuha shqipe në përgjithësi ballafaqohet më pak me këtë problematikë, por ndërrimet e vendeve të fjalëve shkaktojnë mosmarrëveshje në të shumtën e rasteve të degjuesi a lexuesi. Për këtë vlen ta marrim edhe këtë periudhë: *Ata besoj se shkaktonin trazira dhe dëmtonin të korrat*, në të cilën shohim qartë se që në fillim ka diçka të paqartë, mu nga fakti i mosrenditjes së duhur të fjalëve në këtë njësi sintaksore, ngase e kemi kryefjalën *ata*, pastaj vjen folja-kallëzues *besoj* menjëherë, që në fakt nuk përputhet me kryefjalën etj. Mirëpo, një lexim ose degjim pak më i vëmendshëm mundëson një zberthim ndryshe: Shihet se folja *besoj* nuk ka të bëjë me kryefjalën *ata*, por thjesht ka qenë një renditje jo e drejtë e fjalëve në këtë periudhë nga ana e një artikullshkruesi. Prandaj, kjo periudhë është dashur të kishte këtë renditje fjalësh: **Besoj se ata shkaktonin trazira dhe dëmtonin të korrat**.

²Shih Lutz Götze, Ernest W.B. Hess- Lüttich; *Grammatik der Deutschen sprache*, München, 1999, f.377.

³Shih Olivier Soutet, *La syntaxe du française*, bot.3. Paris, 1998, f. 14.

3 Eliminimi

Ka të bëjë me heqjen e atyre gjymtyrëve në fjali që për kuptim janë të dorës së dytë. Për këtë mund të merren shembuj të ndryshëm si: *Burri lexon një libër. Ajo banon me vite të tëra në Mynih.* Kështu, fjalia e parë, pa e humbur fare kuptimin mund të përdoret si: *Burri lexon*, duke e eliminuar fjalën *një libër*; kurse e dyta si: *Ajo banon në Mynih*, duke e eliminuar togfjalëshin me vite të tëra. Eliminimi mund të bëhet edhe në njësitë sintaksore prej 3- 4 fjalish. Kështu, bie fjala, ne mund të themi: *Stilolapsi përbëhet prej dy pjesësh*: Njëra pjesë është kryesore, kurse pjesa tjetër është kapaku. Në pjesën kryesore gjendet penda. Të gjitha këto fjali mund t'i eliminojmë në vetëm këto fjali: *Stilolapsi përbëhet nga dy pjesë*: nga penda si pjesa kryesore dhe kapaku dhe kështu, njësisë së fundit kuptimisht dhe gramatikisht të mos i mungojë asgjë nga njësitë bazë. Pra, me eliminim sa johen njësitë *minimale* që kanë kuptim ekuivalent me njësitë bazë.

4 Adicioni

Ka të bëjë me shtimin e ndonjë gjymtyrë, të ndonjë togu madje edhe të ndonjë fjalie të ndërmjetme (në kuadër të SN- së, SV- së, SP- së etj.) të një fjalie të dhënë. P.sh. fjalisë së dhënë pak më lart: *Postieri i fshatit shpërndan letrat në orën tetë*, ka mundësi t'i shtohet edhe ndonjë gjymtyrë, si p.sh. *Postieri i fshatit, për çudi, i shpërndan letrat në orën tetë*, ose: *Postieri i fshatit i shpërndan rregullisht letrat në orën tetë* ose: **Është për t'u çuditur** pse postieri i fshatit i shpërndan gjithmonë letrat në orën tetë; *Postieri i fshatit tonë, pa u vonuar asnjëherë, i shpërndan letrat në orën tetë* etj.

5 Transformacioni

Është një prej operacioneve më të rëndësishme në ndërtimet sintaksore. Te transformacionet është me rëndësi që njësitë kuptuese- sintaksore të shprehen me mjete të ndryshme gjuhësore, por që kuptimisht të jenë ngjashme ose sinonimike, p.sh.: në ndërtimet: *Ai vjen nesër që ta nënshkruajë kërkesën* dhe: *Ai vjen nesër për ta nënshkruar kërkesën*, formalisht dallohen nga nuancat gramatikore, sepse te e para, në mes të fjalisë kryesore dhe fjalisë së varur ekziston lidhëza nënrenditëse qëllimore *që + lidhorja*, kurse te e dyta është paskajorja **për ta nënshkruar**, po ashtu me vlerë qëllimore.

Ekzistojnë edhe **transformacionet pasive**, të njohura nga vështrimet gjuhësore transformacionale të N.Çomsky-t, të cilat mjaft shpesh përdoren edhe në gjuhën tonë, si: *Shoqatat humanitare ndërkombëtare ndërtuan shkollën e fshatit tonë*, dhe: *Shkolla e fshatit tonë u ndërtua nga shoqatat humanitare ndërkombëtare*. Në të dy rastet kuptimi mbetet i njëjtë, por vetëm formalo- gramatikisht ato dallohen, ngase shprehen në mënyra të ndryshme. Në shembullin e parë: *Shoqatat humanitare ndërkombëtare* është kryefjala e shprehur me togfjalësh, që kuptimisht është vepruesi i fjalisë, kurse togfjalëshi: *shkollën e fshatit tonë*, është kundërinori i drejtë i zgjeruar me përcaktorë, që është rezultat i tyre. Në fjalinë e dytë është e kundërta: *Shkolla e fshatit tonë*, del si kryefjalë formale-gramatikore, ndërsa gjymtyra *nga shoqatat humanitare ndërkombëtare*, që semantikisht

është, siu thamö mö lart, vepruesi, del si *kundrinor me parafjalë*, formalo- gramatikisht.

Në kuadër të operacioneve duhet të hyjë edhe **nominalizimi**, i cili te disa gjuhë, si p.sh. në gjuhën gjermane është shumë i zhvilluar. Khrs. p.sh.: Wir essen Mittag. Danach suchen wir Pilze. Nach dem Mittagessen suchen wir Pilze⁴. Edhe në gjuhën tonë është i shprehur nominalizimi i trajtave foljore, por jo në atë masë, bie fjala, si në gjuhën e sipërpërmendur. Edhe në gjuhën tonë ndërtimi: *Nuk u morën parasysh shumë faktorë të tjerë dhe kjo, më vonë, shkaktoi telashe të reja*, ka mundësi të nominalizohet në këtë mënyrë: *Mosmarrja parasysh e shumë faktorëve të tjerë, më vonë, shkaktoi telashe të reja*.

Ky lloj operacioni përdoret mjaft shumë në literaturën shkecore. Këtu gjejmë shpesh herë trajta foljore të nominalizuara, sinë shembullin: *Boshtin kryesor të punimit e përbën trajtimi i aspiratës së ligjshme të popullit shqiptar për zgjidhjen e problemit kombëtar, për korrëgjimin e padrejtësisë historike të së kaluarës....etj.*

Në gjuhën gjermane, frënge etj., këto operacione quhen **teste (testen)** ose **probe (Umstellprobe, Verschiebeprobe, Ersatzprobe, Austauschprobe, Weglassprobe, Umformungsprobe; etj⁵)**.

⁴Shih për këtë: Karl-Ernst Sommerfeldt; *Operationale Grammatik des Deutschen*, München, 1993, f.152.

⁵Shih Grup autorësh, Duden, *Die Grammatik*, 4, Mannheim, Leipzig, Wien, Zürich, 1998, f.620-623; Karl- E.Sommerfeldt, *Operationale Grammatik des Deutschen*, München1993,149/152;Ch. Dürscheid, *Syntax*, Wiesbaden, 2000, f. 47- 54; O- Soutot, *La syntaxe française*, bot. 3, Paris, 1998, f. 12-14 etj.